



Pranimi / Dorezimi Received/Delivery	12.01.2022	2	vitet years
Organ / Shënia Org / Unit	Dr. Prof Dr. Prof Prof. No.	Shtetja Profesj Appointe	Sasia Kohëzina Quantity
SKIDNSHCK	90/2022		1/3



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.1206/2021**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave** i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jetin Koci-anëtarë si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.177/2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 14.12.2021, ka rishqyrtuar ankesën A/02/756/2017 të datës 31.10.2017 të ankueses me adresë: kundër organit të punësimit Administratës Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 12.01.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**Pezullohet** procedura administrative e nisur sipas ankesës A/02/756/2017 e datës 29.11.2017 të ankueses

**A r s y e t i m**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës me datë 29.01.2018 ka nxjerrë Vendimin me numër A/02/756/2017 me të cilin e ka aprovuar si të bazuar ankesën e ankueses të datës 31.10.2017 ndërsa e ka anuluar konkursin e datës 13.06.2017 me numër reference INS/230/JP00028736 për pozitën “Inspektor Tatimor-30 pozita” të shpallur nga Administrata Tatimore të Kosovës, njëherit ka shfuqizuar vendimin me nr protokolli 199 i datës 31.10.2017 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të ATK-së.

Administrata Tatimore e Kosovës ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës-Departament për Çështje Administrative, ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinës-Departament për Çështje Administrative ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.177/2018 të datës 14.12.2021 me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa e ka anuluar Vendimin A/02/756/2017 e Këshillit të datës 29.01.2018 duke e kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova: Aktgjykimin A.nr.177/2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 14.12.2021; Procesverbalin e seancës kryesore për lëndën A/02/756/2017 të datës 31.10.2017.nr.177/2018 i datës 23.11.2018; Autorizimin e datës 12.10.2021 Procesverbalin e seancës kryesore për lëndën A.nr.176/2018 i datës 23.11.2021; Procesverbalin e seancës për lëndën Anr.177/2018 të datës 04.11.2020; Autorizimi i datës

02.11.2020; Përgjigjen në padi të datës 11.06.2019; Aktvendimin A.nr.177/2018 e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 10.03.2018; E-mailin e datës 17.10.2018 me korrespondencën e bashkangjitur me numër protokoll 6050/2018; Aktvendimin A.nr.176/2018 e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 17.05.2019; Padinë e paditëses Administrata Tatimore e Kosovës e datës 05.02.2018; Ankesën e ankueses të datës 29.11.2017 me numër prot:6212/2017; Njoftimin e datës 02.02.2018; Vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të ankesave të datës 31.10.2017 me numër :93/2017;Aktvendimin A.nr.177/18 i datës 07.02.2018 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Vendimi A/02/406/2017 i datës 16.10.2017 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail zyrtar i datës 15.11.2017; Vendimi nr.19/2017 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës; Ankesë e datës 17.07.2017 e parashtruar nga ankuesja në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Njoftimi i kandidatëve për testimin nga përzgjedhja e ngushtë i datës 14.07.2017; Kopja e konkursit i datës 13.06.2017; Kërkesa për punësim e datës 16.06.2017 për Cv-personale për Diploma Master e datës 21.07.2016; Diplomë e datës 28.12.2009 AAB-RIINVEST; Çertifikatë e datës 22.06.2012; Çertifikatë e datës 12.05.2010; Çertifikatë e datës 29.04.2010; Vërtetim i datës 30.11.2014; Letër rekomandimi e datës 24.05.2011; Referencë e datës 16.05.2011; Referencë e datës 01.06.2010; Kopja e letërnjoftimit ; kopja e patent shoferit; Vërtetim i datës 25.05.2009; Fletrekomandim për kryerjen e Praktikës Profesionale në Departamentin e Buxhetit i datës 10.04.2008; Çertifikatë e datës 19.01.2017 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë dhe Njoftim për test me shkrim.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për rivendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ka bazë të mjaftueshme ligjore si dhe ekzistojnë rrethana të reja të cilat e plotësojnë kushtin që vendimmarrja për lëndën A 02/756/2017 të ankueses të **pezullohet, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, sipas Aktgjykimit A.nr.177/2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 14.12.2021 ka rishqyrtuar lëndën e ankueses sipas ankesës A.02/756/2017 të datës 29.11.2017, mirëpo për të njëjtin objekt shqyrtimi-konkursin e datës 13.06.2017 me numër reference INS/230/JP00028736 për pozitën “Inspektor Tatimor-30 pozita” të shpallur nga Administrata Tatimore të Kosovës, Këshilli ka vendosur edhe me Vendimin A.02/756/2018 të datës 29.01.2018 për ankesën e ankueses duke e aprovuar si të bazuar ankesën ndërsa e ka anuluar konkursin e datës 13.06.2017 me numër reference INS/230/JP00028736 për pozitën “Inspektor Tatimor-30 pozita” të shpallur nga Administrata Tatimore të Kosovës, kurse Administrata Tatimore e Kosovës ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës-Departament për Çështje Administrative, ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinës-Departament për Çështje Administrative ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.177/2018 të datës 14.12.2021 me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa ka anuluar vendimin e Këshillit A.02/756/2018 të datës 29.01.2018. Administratat Tatimore e Kosovës me datë 01.12.2021 ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative kundër Aktgjykimit A.nr.175/2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinës-Departament për Çështje Administrative të datës të datës 30.09.2021.

Meqenëse Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative për të njëjtin rast ka nxjerrë dy (2) aktgjykime të cilat janë të kundërta me njëra tjetrën dhe përderisa një lëndë është duke u trajtuar në Gjykatën e Apelit të Kosovës për të njëjtin objekt shqyrtimi, Kolegji konstaton se në kuptim të nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: **“Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: “çështje paraprake”), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit”,** ekzistojnë rrethana të mjaftueshme që rishqyrtimi i lëndës A.02/756/2017 të pezullohet deri në vendosjen përfundimtare nga Gjykata e Apelit të Kosovës sipas ankesës



së datës 29.11.2021 të paditëses Administratat Tatimore e Kosovës, pasi që objekti i shqyrtimit është i njëjtë dhe shërben si parakusht për zgjedhjen e çështjes kryesore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, pas vendosjes së rastit nga Gjykata e Apelit të Kosovës, sipas ankesës së paditëses Administrata Tatimore e Kosovës të datës 01.12.2021 ndërlidhur me rastin që për objekt të shqyrtimit ka konkursin e datës 13.06.2017 me numër reference INS/230/JP00028736 për pozitën "Inspektor Tatimor-30 pozita" të shpallur nga Administrata Tatimore të Kosovës, do të vendos edhe për lëndën A.02/756/2017 të ankueses

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nënit 85 Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.1206/2021**

**Sabile AVDYLI**

*Sabile Avdyli*  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHICK-së.

